



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 16

Tiranë – E martë, 9 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Udhëzim plotësues i ministrit të Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016.....	1017
Financave nr. 1, datë 15.1.2016	

**UDHËZIM PLOTËSUES****Nr. 1, datë 15.1.2016****PËR ZBATIMIN E BUXHETIT
TË VITIT 2016**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 19, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016” dhe në vijim të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2, ministri i Financave,

UDHËZON:

I. Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit

Të përgjithshme

1. Për çdo njësi shpenzuese të krijuar rishtazi, çelet kodit përkatës në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), pas paraqitjes së kërkesës zyrtare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, e shoqëruar detyrimisht me aktin përkatës ligjor ose nënligjor, apo akte të tjera administrative të krijimit të saj. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e mbylljes së një njësie shpenzuese.

2. Për çdo njësi arkëtuese jo shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe për çdo njësi arkëtuese jo buxhetore (për shembull, njësitë me vetëfinancim etj.), çelet kodit përkatës në SIFQ në zbatim të aktit përkatës ligjor ose nënligjor apo akte të tjera administrative të krijimit të saj.

3. Njësitë shpenzuese gjatë përdorimit të fondeve buxhetore të planifikuara për “Mallra e shërbime”, me prioritet urdhërojnë pagesat për shërbimet e furnizimit me energji elektrike (në kushtet e mungesës së likuiditetit dhe/ose planit të arkës, respektohet renditja në pikën 139 të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”). Strukturat përgjegjëse për Thesarin në degë, verifikojnë listën e debitorëve të dërguar nga OSHEE-ja çdo muaj dhe autorizojnë pagesën e faturave të tjera, vetëm nëse njësi shpenzuese nuk rezulton me detyrime të papaguara në këtë listë. Në rast të kundërshtimeve, njësi shpenzuese rakordon me OSHEE-në dhe vetëm pas sqarimit zyrtar të detyrimit vijnë pagesat e tjera. Në rast se detyrimi

është objekt i një çështjeje gjyqësore, njësi shpenzuese duhet të paraqesë një dokument që vërteton se çështja është në proces gjyqësor. Këto përcaktime janë të vlefshme edhe në rastin kur institucionet përfitojnë fonde buxhetore në formën e subvencioneve.

4. Letër krediti i qeverisjes së përgjithshme (LC) është instrument pagese i kërkuar në kushte specifike të zbatimit të buxhetit nga njësi shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme. Ky instrument pagese aplikohet duke transferuar paratë nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e qeverisë” në bankën e nivelit të dytë, në një llogari bankare të çelur me emërtimin e projektit të kontraktuar në pronësi të njësisë shpenzuese deri në momentin e livrimit të mallit/shërbimit.

Detajimi i disa fondeve buxhetore

5. Fondi i planifikuar për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, në artikullin 604, detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të VKM-së, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FDSKSH) paraqet te nëpunësi i parë autorizues, detajimin sipas strukturave buxhetore të miratuara. Fondet për spitalet bëhen të disponueshme në kapitullin 8 (“Burimi i fondit buxhetor”).

6. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, janë planifikuar fondet për investime për arsimin universitar edhe në formën e Fondeve për Zhvillimin e Rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë do të përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes së projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilat miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë mund të bashkëfinancojnë për objekte investimesh edhe nga të ardhurat e veta.

7. Zbatimi i vendimeve gjyqësore që lidhen me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe rikthimi i vlerave të arkëtuara subjekteve që u është ndërprerë procesi i legalizimit në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin e integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, do të përballohen me të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë e kompensimit të pronave.

8. Investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore çelen në strukturën: Ministria e linjës 00, Program xxxxx, Kapitull 01, të specifikuar me kode projekti. Shkresat e çeljes së



këtyre fondeve do të hidhen në SIFQ nga struktura përgjegjëse për Thesarin në degë. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtën e ndryshimit të emërimit të projekteve. Fondet e investimeve të qeverisjes vendore nga Fondi i Zhvillimi të Rajoneve, të papërdorura në vitin 2015, të çelura me kod projekti M99xxxx do të trashëgohen në 2016, në Kapitull 01.

9. Fondet e investimeve, të akorduara për Fondin Shqiptar të Zhvillimit në programin me kod 04590 “Mbështetje për infrastrukturën urbane dhe rurale”, për infrastrukturën vendore, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, të cilat rezultojnë të papërdorura në fund të vitit 2015, do të mbarten në vitin pasardhës në të njëjtën strukturë buxhetore, pas rakordimeve përkatëse të degës së Thesarit me FSHZH-në.

10. Fondet për projektet e investimeve, të akorduara për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, me vendime të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për infrastrukturën vendore, shtylla II “Shqipëria dixhitale”, që rezultojnë të papërdorura në fund të vitit 2015, do të mbarten në vitin e ardhshëm në të njëjtën strukturë buxhetore, pas rakordimeve përkatëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme me degën e Thesarit. Një kopje e këtij aktrakordimi paraqitet nga ministria/institucioni qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, gjatë procesit të rakordimit të planit të buxhetit.

11. Në procesin e menaxhimit të investimeve publike njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë parasysh kërkesat e urdhrin nr. 166, datë 31.12.2015, “Për krijimin e Bordit të Investimeve”.

12. Detajimi i fondeve për investime të miratuara në ligjin nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, si dhe kërkesat për rishpërndarje apo për fonde shtesë për investime, do të paraqiten për konfirmim pranë ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Pas shqyrtimit, konfirmimi përkatës, nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të paraqitet për miratim pranë ministrit të Financave dhe për njoftim pranë njësisë të qeverisjes qendrore. Njësitë e qeverisjes qendrore, në detajimin e planeve të miratuara të investimeve do të mbajnë parasysh këto kritere dhe përparësi në financimin e projekteve:

a) Projektet e investimeve të propozuara për financim duhet të jenë pjesë e projekteve të propozuara dhe të shqyrtuara nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitura në Kuvend, për vitin 2016;

b) Në detajimin e investimeve të miratuara nga MZHETTS-ja për njësitë e qeverisjes qendrore do të përfshihen edhe fondet e ngurtësuar, të cilat në total janë 4 miliardë lekë dhe që do të përdoren gjatë vitit 2016 kundrejt arkëtimit të të ardhurave nga dividendi në të njëjtën masë, sipas përcaktimit në nenin 10 të ligjit 147, datë 17.12.2015, “Për ligjin e buxhetit të vitit 2016”.

c) Projektet në vazhdim nga viti 2015 ose më parë, do të financohen me përparësi dhe duhet të jenë pjesë e prioritetëve të propozuara për financim gjatë vitit 2016.

d) Detyrimet lokale për TVSH-në, taksa doganore ose bashkëfinancimet nga buxheti i shtetit për projektet me financim të huaj, do të financohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar për vitin 2016. Financimi i projekteve me financim të huaj nuk duhet të tejkalojë tavanin e miratuar në ligjin e buxhetit për vitin 2016.

e) Projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së 2016–2018, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore. Propozimet për financimin e projekteve të reja do të shoqërohen me relacionin dhe formularët përkatës në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në shtojcën 6 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të udhëzimit nr. 8, datë 27.2.2015 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016–2018”.

f) Propozimet për projekte të reja të papërfshira në sa më sipër, do të financohen vetëm në kushtet e emergjencës, të shoqëruara me një relacion të hollësishëm për domosdoshmërinë e investimit të kërkuar dhe pas miratimit paraprak nga ana e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS).

Projektet e reja që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe janë me vlerë deri në 700 milionë lekë, do të financohen vetëm pas miratimit paraprak të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Projektet



prioritare me vlerë mbi 700 milionë lekë do të financohen vetëm pas shqyrtimit dhe miratimit paraprak në Komitetin Ndërmintor për Zhvillimin Ekonomik.

Shtesat në planin e miratuar të projekteve të investimeve publike në kuadër të kontratave për punime shtesë ose të ndryshimeve në planin e projekteve, si dhe rialokimet e fondeve ndërmjet projekteve gjatë zbatimit të buxhetit, do të bëhen me miratim paraprak të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, bazuar në relacionin dhe argumentet mbi domosdoshmërinë e tyre.

Nëse projekti i propozuar nuk ka qenë pjesë e PBA-së 2016–2018 dhe nëse nuk plotëson asnjë nga kushtet e mësipërme, kërkesa për financim duhet të paraqitet vetëm në kuadër të rishikimit të buxhetit vjetor.

13. E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve për investime, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të vitit, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesës për rialokim pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

14. Projektvendimet e Këshillit të Ministrave, të cilat lidhen me investime publike, duhet të paraqiten për mendim në Ministrinë e Financave, pas marrjes së miratimit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Ministria e linjës duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave një kopje të shkresës së MZHETTS-së dhe konfirmimi nga MZHETTS-ja duhet të jetë pjesë e relacionit shoqërues të projektvendimit të paraqitur për miratim.

15. Fondet për projektet e reja të investimeve për blerjen e pajisjeve elektronike/informatike, të cilat nuk e kanë ndjekur ciklin e planifikimit të investimeve publike dhe që lidhen me Teknologjinë e Informacionit, bëhen efektive pas konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Në rastet kur në marrëveshjen dypalëshe, të nënshkruar për zbatimin e projekteve me financim të huaj, është përcaktuar që disbursimi nga donatori/kreditori do të bëhet pasi të jetë kryer shpenzimi dhe pasi të jetë vlerësuar performanca e projektit, atëherë për kryerjen e shpenzimit, ministritë/institucionet, në rast se nuk kanë parashikuar fondet përkatëse në planin e buxhetit

vjetor, do të shqyrtojnë mundësinë e një rialokimi për të siguruar fondet e nevojshme.

Fondet e rimbursuara nga financuesi sipas projekteve përkatëse, do të regjistrohen në një zë të veçantë për t'u dalluar nga grantet dhe kreditë e tjera, me emërtimin “Rimbursim i shpenzimeve pas vlerësimit të performancës”.

Numri i punonjësve buxhetorë dhe shpenzimet e personelit

16. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me emërtesën e institucionit dhe numrin përkatës të saj të përcaktuar në urdhrin e miratimit të strukturës së çdo institucioni varësie. Si rregull, ky numër i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1 shkurt 2016, ndërsa në muajin janar, për pagesat e punonjësve do të operohet me numrin e punonjësve të muajit dhjetor të vitit 2015.

17. Në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, për vitin 2016 nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësisë të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe ato struktura në të cilat, paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogarit, sipas gradave të miratuara. Përfundimisht bëjnë institucionet e reja të krijuara gjatë vitit buxhetor.

18. Efektet financiare të ndryshimit të strukturave të njësisë të qeverisjes qendrore vlerësohen nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave.

19. Numri rezervë i punonjësve përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit dhe alokohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e detajimit dhe të miratimit përcaktohen në të njëjtën mënyrë si për punonjësit në organik.

20. Punonjësit me kontratë të përkohshme pune, mbi numrin organik të miratuar për njësitë shpenzuese, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Punonjësit të cilët merren me anketime të ndryshme në Institutin e Statistikës, punonjësit që përfshihen në procesin zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, instruktorët e qendrave të formimit profesional, si dhe mësuesit në dispozicion në arsimin parauniversitar dhe arsimin pro-



fesional nuk përfshihen në këtë vendim. Miratimi i numrit të këtyre punonjësve, afatet kohore dhe të tjera specifitime për kontraktimin me kohë të pjeshme të tyre, bëhet sipas udhëzimit të përbashkët të institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë së Financave.

Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin e vitit 2016, të njësive të qeverisjes qendrore dhe regjistrohen në të njëjtën mënyrë si shpenzimet e personelit organik. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar për qendrat e transferimit të teknologjisë bujqësore, Shtëpinë e Pushimit Durrës (të MPB-së), Shtëpinë e Pushimit të SHISH-it dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit. Për punonjësit e kontraktuar për ALUIZNI-n dhe qendrat e formimit profesional efektet financiare përballohen pjesërisht nga të ardhurat dhe pjesërisht nga fondet buxhetore të miratuara për vitin 2016.

21. Çdo ndryshim i numrit të punonjësve nga një njësi shpenzuese tek tjetra, shoqërohet me aktin përkatës të strukturës së miratuar të njësive shpenzuese. Nga ky rregull përjashtohen:

a) Institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme dhe i gjykatave, për transferimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve nga një njësi shpenzuese në një tjetër. Miratimi i ndryshimit të numrit të punonjësve organikë bëhet pas vlerësimit të kostos financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit të shoqëruar me urdhrin përkatës të emërimit të prokurorit / gjyqtarit.

b) Transferimi i numrit të punonjësve mësimorë organik, nga një shkollë në tjetrën, bëhet pas vlerësimit të kostos financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit qendror.

22. Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore përdoret nga çdo njësi shpenzuese për numrin faktik mujor të punonjësve në organikë, brenda numrit limit të miratuar. Nuk lejohet përdorimi i fondit të lirë që rezulton nga strukturat e paplotësuara apo nga reduktimi i strukturave aktuale. Vetëm në raste specifike, përdorimi i këtij fondi miratohet nga Ministria e Financave. Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore përdoret për pagesën e punonjësve me kontratë të përkohshme

pune, kur është parashikuar një fond i tillë nga Ministria e Financave.

23. Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahen në konsideratë rregullat e përcaktuara në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

24. Plotësimi i borderosë së pagave të bëhet sipas shtojcës nr. 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

25. Për punonjësit me kontratë hartohet bordero e veçantë.

Fondi i veçantë

26. Fondi i veçantë i njësive shpenzuese nuk është pjesë e fondit të pagave, pasi ky fond do të alokohet dhe përdoret me miratim të ministrit të Financave.

27. Limiti maksimal i fondit të veçantë, i parashikuar për t'u përdorur për çdo njësi të qeverisjes qendrore, është përcaktuar në tabelën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Njësitë e qeverisjes qendrore njoftojnë të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë për limitin maksimal të fondit të veçantë për t'u shpenzuar prej tyre. Përdorimi i fondit të veçantë bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar.

28. Kërkesat për përdorimin e fondit të veçantë brenda limitit të njoftuar do të paraqiten rast pas rasti nga njësitë e qeverisjes qendrore te nëpunësi i parë autorizues, i cili i shqyrton nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe i propozon për miratim te ministri i Financave. Kjo kërkesë duhet të përmbajë edhe informacionin lidhur me shumën e përdorur nga fondi i veçantë deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë.

29. Në fondin limit të përcaktuar sipas pikës 27, nuk përfshihet fondi i veçantë i njësive të qeverisjes vendore, i Fondeve të Sigurimeve Shoqërore, i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i universiteteve, i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për Bashkitë dhe i Qendrës Kombëtare të Licencimit për Bashkitë. Për këto institucione, kërkesa për përdorim nga fondi i veçantë me destinacion të përcaktuar në shkresë, paraqitet nga njësia shpenzuese në degën e Thesarit, duke respektuar kriteret e VKM-së nr. 929, datë 17.11.2010, i ndryshuar. Në rast të përdorimit, ai transferohet nga vetë njësitë nga artikulli 600 në artikujt 602 dhe 606, sipas natyrës së shpenzimit. Një kopje e kësaj kërkesë paraqitet nga dega e Thesarit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit



për t'u regjistruar në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.

Kontrolle financiare paraprake shtesë në procesin e menaxhimit të fondeve publike

30. Me qëllim menaxhimit financiar eficient të fondeve publike dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të papaguara në kohë, në nenin 10 të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016", janë miratuar tavanet buxhetore për çdo program, të ndara për shpenzime korente dhe shpenzime kapitale për vitet 2017 dhe 2018.

31. Me vendimin nr. 110, datë 27.2.2014, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar kufijtë për limitet e angazhimeve shumëvjeçare. Për zbatimin e këtyre rregullave çdo njësi e qeverisjes qendrore, gjatë detajimit të buxhetit vjetor, detajon edhe tavanet për limitet e angazhimit për institucionet e varësisë. Ndërsa detajimi i buxhetit 2016 bëhet pjesë e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, limitet e angazhimit për vitet 2017 dhe 2018, depozitohen në degët e Thesarit të rretheve për t'u regjistruar në një pasqyrë të veçantë jashtë Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, deri në momentin që sistemi do të zgjerohet duke përfshirë edhe këto vite. Për vitin 2019, limiti i angazhimit depozitohet me miratimin nga Këshilli i Ministrave të tavanëve përgatitore 2017–2019.

32. Kontrolli mbi limitet e angazhimit përfshin këtë procedurë:

- Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme depoziton regjistrin e prokurimeve publike zyrtarisht dhe elektronikisht në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe degën e Thesarit në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo ndryshim të tij gjatë vitit, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve duhet të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor.

- Në rast se parashikohen prokurime për kontrata shumëvjeçare, ato duhet të paraqiten në regjistër, duke specifikuar veçmas fondin e nevojshëm për vitin buxhetor 2016 dhe fondet e parashikuara për secilin vit buxhetor, deri në plotësimin e shërbimeve/punimeve të planifikuara.

- Dega e Thesarit kryen kontrollin e totalit të fondeve të paraqitura në regjistrin e prokurimeve me totalin e fondeve të miratuara në buxhetin e njësisë dhe vetëm pasi vulozet nga Thesari urdhri i prokurimit, njësia mund të fillojë procesin e prokurimit në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

- Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, regjistrojnë në sistem çdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

- Të gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet të paraqiten në degën e Thesarit, së bashku me ftesën për prokurim, të cilat duhet: i) t'i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në Thesar; ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulozen nga dega e Thesarit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik.

- Dega e Thesarit informon strukturën përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave, një herë në muaj, brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës, mbi urdhrat e prokurimit të miratuara prej saj, sipas strukturës buxhetore.

- Nëse në degën e Thesarit paraqitet një urdhërprokurimi i pambuluar me fonde buxhetore, atëherë dega e Thesarit refuzon me shkrim dokumentin e paraqitur dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik. Në asnjë rast, Agjencia e Prokurimit Publik nuk fillon procedurën zyrtare të prokurimit, pa pasur më parë një miratim të degës përkatëse të Thesarit.

33. Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të paraqiten dhe të procedohen në degën e Thesarit përkatës sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e Thesarit procedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë nëpunësin e parë autorizues, i cili ndërmerr masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e Thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimin e kryer.

34. Ministria e Financave zhvillon monitorime çdo katër muaj të të gjitha ministrisë e linjës, nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë, për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2016 dhe kryen një analizë, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi.



35. Rregullat dhe procedurat më të detajuara për regjistrimin dhe raportimin e limiteve të angazhimit përcaktohen me udhëzim të veçantë.

Menaxhimi i likuiditetit

36. Njësia e qeverisjes së përgjithshme paraqet urdhërshpenzimin, duke përcaktuar qartë datën e pagesës së faturës sipas kontratës.

Në SIFQ regjistrohet data e faturës së furnitorit, data e urdhërshpenzimit të përgatitur dhe paraqitur në Thesar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, data e regjistrimit të urdhërshpenzimit në SIFQ, si dhe data në të cilën duhet të kryhet pagesa për faturën respektive, e cila duhet të jetë në përputhje me kushtet e kontratës. Ky rregull zbatohet edhe nga institucionet buxhetore që kanë akses të drejtpërdrejt në SIFQ.

37. Niveli (“buffer”) i gjendjes monetare të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” përcaktohet si mesatarja mujore e shpenzimeve të planifikuara dhe të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit për zërat: shpenzime korrente të personelit, si dhe shpenzime sociale për ndihmën ekonomike dhe papunësinë (pagesat e shërbimit të borxhit mbulohen me emetimet e ankandeve të letrave me vlerë të qeverisjes qendrore), që përbën kufirin maksimal në fillim të çdo muaji. Kufiri minimal përcaktohet në bazë të të dhënave të parashikimit të flukseve monetare hyrëse dhe dalëse të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (versionit pesimist të Thesarit) në masën e mesatares së parashikimit të tre ditëve (rreth tre miliardë lekë) të pikut të muajit të mëparshëm.

38. Për sa përcaktuar më sipër, niveli i “buffer” mund të jetë fleksibel gjatë zbatimit në përshtatje me kushtet aktuale.

Transaksionet në valutë të huaj

39. Gjatë procesit të menaxhimit të shpenzimeve të projekteve me financim të huaj, që administrohen me skemë të pjesshme Thesari, transfertat nga llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë në llogaritë bankare të projekteve me financim të huaj, kryhen në monedhën shqiptare nga struktura qendrore përgjegjëse për Thesarin, përveç kontratave të lidhura në valutë të huaj dhe të shprehura në nenin e veçantë të kontratës për mënyrën e pagesës, sipas paragrafit 145 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012.

Llogaritë speciale

Llogaria speciale e të përndjekurve politikë

40. Nëpunësi autorizues i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë përdor fondet e planifikuara për të përndjekurit politikë në grupin 25, në masën dhe sipas listëpagesave të miratuara nga nëpunësi i parë autorizues.

41. Në udhëzimin nr. 9, datë 11.4.2012 “Për procedurat e përlllogaritjeve dhe pagesave të dëmshpërblimeve për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, pikat 14 dhe 15 bashkohen dhe ndryshojnë si më poshtë: “Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave harton listëpagesën dhe mbi bazën e tyre përpilon përmbledhësen për çdo bankë. Përmbledhësja totale e pagesave, e detajuar për çdo bankë të nivelit të dytë, i dërgohet nëpunësit autorizues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për procedimin e pagesës në llogaritë e bankave të nivelit të dytë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të Thesarit në degë”.

42. Në prioritetet e pagesave sipas pikës 139, të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, të konsiderohet prioritet “transaksioni i pagesës për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve”, në renditje direkt pas pagesës “ndihmë ekonomike”.

43. Çdo pagese e procesuar në bankat e nivelit të dytë që rezulton me instruksione të gabuara bankare të kthehet brenda 24 orëve për t’u riprocesuar pas korigjimit të gabimit.

Llogaria speciale e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë

44. Llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë përbëhet nga:

a) Gjendja e trashëguar nga vitet e kaluara e papërdorur, por e angazhuar tërësisht me vendime të Këshillit të Ministrave, që ka mbetur në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” në Bankën e Shqipërisë, e cila do të përdoret me paraqitjen e listës së përfituesve në zbatim të VKM-ve të miratuara. Strukturat përgjegjëse të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojnë listat përpara tri viteve të mëparshme dhe të raportojnë zyrtarisht (me protokoll dhe në format elektronik) gjendjen e saktësuar në strukturën përgjegjëse për Thesarin në Ministrinë e Financave.

b) Shuma e papërdorur deri në datën 31 dhjetor të vitit 2015 e krijuar me aktin normativ nr. 2, datë 11.12.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit



2015”, të ndryshuar” do të përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave në vitin 2016.

Llogari të veçanta në bankat e nivelit të dytë

45. Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve deri më datën 31 dhjetor, përveç rasteve specifike të mëposhtme:

a) Ekzistenca e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur (fatura e furnitorit) nuk mund të shoqërohet me marrjen në dorëzim të mallit/shërbimit brenda datës 31 dhjetor 2015 për kushte specifike të prodhimit të mallit (si furnizimet strategjike: armatime, helikopterë, rezonanca magnetike etj.) apo kryerjes së shërbimit (mirëmbajtjes së objekteve të rëndësishme strategjike etj.)

b) Përdorimi i mallit apo kryerja e shërbimit ndikon në mosfunksionimin normal të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe është i pamundur planifikimi për vitin e ardhshëm buxhetor.

46. Për rastet e përmendura në pikën e mësipërme lejohet përdorimi i formës së pagesës me letër krediti sipas përcaktimeve të nënshkruara në kontratën me operatorët ekonomikë në bazë të urdhrimit të ministrit të Financave, në zbatim të pikës 147, të udhëzimit të përherëshëm nr. 2, datë 6.2.2015, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

47. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë pranon njohjen dhe regjistrimin në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të shpenzimeve për llogari të vitit 2015, që konstatohen në zbatim të pikës së mësipërme. Regjistrimi i faturave duhet të përfundojë dhe të kryhet rakordimi përfundimtar me institucionin, sipas afatit të caktuar në udhëzimin e mbylljes së llogarive vjetore. Pagesa kryhet nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e qeverisë” në një llogari të veçantë të çelur në bankën e nivelit të dytë me emërtimin e projektit të kontratës, sipas përcaktimeve të nënshkruara me operatorin ekonomik.

48. Gjendja më 31 dhjetor e llogarive të veçanta bankare në pronësi të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme që krijohen nga përdorimi i formës së pagesës me letër krediti si më sipër raportohet në të dhënat e treguesve fiskale të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme në zërin “Të tjera” të burimeve të brendshme të financimit.

Të ardhurat jashtë limitit

49. Në të ardhurat jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e “Procedurave standarde të zbatimit të buxhetit”, përfshihen edhe të hyrat e mëposhtme:

a) Të hyrat që mbliidhen nga zyrat e përmbarimit për llogari të të tretëve;

b) Të ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga loto sportive ose nga sponsorizimet e tjera;

c) Fondet e akorduara nga Kompania Energjetike Shqiptare për përballimin e dëmeve nga përmblytjet;

d) Të ardhurat nga organizmat e vlerësimit të konformitetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, që përdoren për pagesën e vlerësuesve të kontraktuar nga kjo drejtori në zbatim të ligjit nr. 9824, datë 1.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 1716, datë 3.10.2008 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” dhe standardit S SH ISO 17011:2005 që rregullon veprimtarinë e organizmave akreditues;

e) Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje “Për transferimin e parcelës ndërtimore”, sipas aktrakordimit midis zyrës qendrore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritit të Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe strukturave përgjegjëse për Thesarin në degë, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë speciale të fondit të kompensimit të pronave, pranë Bankës së Shqipërisë;

f) Të ardhurat nga Parku Kombëtar i Butrintit;

g) Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, Inspektoratit Qendror Teknik, Institutit të Ndërtimit, Universitetit të Tiranës, Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe strukturës përgjegjëse për doganat shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë;

h) Të ardhurat e realizuara nga shitja e mallrave rezervë shtetërore gjatë procesit të freskimit të mallrave rezervë dhe që përdoren për zëvendësimin e mallrave të shitura;

i) Të ardhurat gjendje të mbledhura nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe



subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, të cilat trajtohen sipas VKM-së nr. 438, datë 20.5.2015, “Për krijimin e fondit Kombëtar të garancisë për kreditimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural”;

j) Të ardhurat nga INSIG-u për pagesat që do të kryhen për rastet e dëmtimit të mjeteve të siguruara;

k) Të ardhurat e realizuara nga pagesat e kryera nga operatori ekonomik për mbulimin e shpenzimeve për punonjësit e rekrutuar në mbështetje të kontratës specifike të nënshkruar midis tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në zbatim të VKM-së nr. 143, datë 13.2.2013, “Për disa shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitatat zbatuese të Kodit Doganor””;

l) Të ardhurat e realizuara nga fondet e transferuara nga ana e partive politike për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat përdoren për kryerjen e pagesave të ekspertëve kontabël të licencuar në zbatim të ligjit nr. 10374, datë 10.2.2011, “Për partitë politike”, të ndryshuar;

m) Të ardhurat e institucioneve, të realizuara nga fondet e akorduara nga “Fondi i Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimit Ligjor”;

n) Të ardhurat si mjete në ruajtje, të realizuara nga shitja e objekteve nën administrimin e ndërmarjeve, në zbatim të VKM-së nr. 418, datë 9.7.1998, të ndryshuar;

o) Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë;

p) Të ardhurat e përftuara nga kontributet e detyrueshme që nga krijimi i “Fondit të çështjeve të mira”, si edhe të ardhurat e institucioneve buxhetore të realizuara nga fondet e akorduara nga “Fondi i çështjeve të mira”, në zbatim të VKM-së nr.192, datë 4.3.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve për përzgjedhjen e projekteve, organizatave apo eventeve nga “Bordi i çështjeve të mira të Lotarisë Kombëtare””;

q) Të ardhurat e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë që sigurohen nga zbatimi i VKM-së nr. 522, datë 30.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga shpronësimi për qëllim ndërtimi, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes

dhe transferimit në favor të shtetit, të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun e Shkodrës”, të ndryshuar”;

r) Të ardhurat e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë që sigurohen në zbatim të pikës 4, nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 10073, datë 9.2.2009, “Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” në të cilin thuhet: “Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksat, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast për llogari të bashkisë ose të komunës, që mbulon territorin ku bëhet investimi”.

50. Në të ardhurat jashtë limitit që nuk mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e “Procedurave standarde të zbatimit të buxhetit”, përfshihen edhe të ardhurat e mëposhtme:

a) Të ardhura nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor;

b) Të ardhurat nga shtëpitë e pushimit të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror, si dhe të ardhurat nga shërbimi i transportit të mjeteve të bllokuara (karroatreci) dhe të ardhurat nga parkimi”;

c) Të ardhurat nga privatizimi që përdoren për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore nga Ministria e Financave që lidhen me procesin e privatizimit, si dhe të ardhurat që përdoren për likuidimin e shpenzimeve të kryera për këtë proces;

d) Të ardhurat deri në 10 milionë lekë, që siguron çdo vit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nga shërbime metrologjie, në zbatim të VKM-së nr. 571, datë 29.8.2012;

e) Të ardhurat e gjykatave nga tarifa e shërbimeve që kryen administrata gjyqësore të përcaktuara në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009;

f) Të ardhurat e realizuara nga ALUIZNI në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar; VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” dhe ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në



zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, që përbëhen nga:

- Të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e tarifës së shërbimit për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe çdo penalitet tjetër që shoqëron procesin e legalizimit;

- Nga 30 për qind e fondit të të ardhurave të arkëtuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore informale, si dhe nga 20 për qind i fondit të të ardhurave të arkëtuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë së truallit në zonat e stimuluar të turizmit, pasi të derdhet në buxhetin e shtetit shuma prej 170.000.000 lekësh.

Këto të ardhura do të përdoren nga ALUIZNI për përballimin e shpenzimeve të evidentimit në terren dhe të hartimit të dokumentacionit për ndërtimet pa leje, si dhe të efekteve financiare për punonjësit me kontratë të përkohshme.

g) Të ardhurat e Ministrisë së Mbrojtjes që do të sigurohen nga shitja e armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive të Forcave të Armatosura për përdorim ushtarak/ jo për përdorim ushtarak/për çmontim e çmilitarizim, shitja e pjesëve të këmbimit të teknikës dhe pajisjeve, shitja e materialeve që përfitohen nga asgjësimi e shkatërrimi i armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 9.7.2014;

h) Të ardhurat që siguron Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nga kontratat e qirasë të lidhura nga ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore me kapital 100 për qind shtetëror, të cilat MZHE'TTS-ja i përdor në zbatim të VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014, “Për mbulimin e shpenzimeve të shoqërive me kapital 100 për qind, që rezultojnë me vështirësi financiare, si edhe për pagesën e ekspertëve që hartojnë vlerësimin e investimeve të kryera nga qiramarrësit për kontratat e qirasë ose të enfiteozës të lidhura për pasuri ku sipërfaqja e truallit është mbi 500 m²”;

i) Të ardhurat që përdor Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave nga arkëtimi i pagesës së tarifave të miratuara për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, në zbatim të VKM-së nr. 883, datë 13.5.2009, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar;

j) Shuma deri në 2% e të ardhurave tatimore të mbledhura, bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 991, datë 9.12.2015, të cilat përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

k) Të ardhurat nga shërbimi pyjor në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, i ndryshuar.

II. Krite dhe procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit vendor

51. Transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore (bashki dhe qarqe), çelet në strukturën: Ministria e linjës 00, Program 04960, Kapitull 01, e ndarë në katër tremujorë, si vijon:

a) Për bashkitë dhe qarqet në tremujorin e parë 30%, të dytën 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%.

Kur njësia e qeverisjes vendore kërkon avancim të limitit tremujor të transfertës së pakushtëzuar, duhet t'i drejtojë zyrtarisht nëpunësit të parë autorizues një kërkesë të argumentuar për avancim fondi. Nëpunësi i parë autorizues pas marrjes së kërkesës nga njësia e qeverisjes vendore bën vlerësimin e kërkesës dhe vendos për avancimin ose jo të fondeve.

52. Transferta specifike për njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë), bashkëlidhur, çelet në strukturën: Ministria e linjës 00, Program xxxxx, Kapitull 01, e ndarë në katër 3-mujorë, si vijon:

a) Për bashkitë në tremujorin e parë 30 %, të dytën 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%.

53. Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar të trashëguar nga viti 2015, të regjistruhen në Kapitullin 01, për t'iu shtuar fondeve të transfertës nga qeverisja qendrore për vitin 2016.

54. Sipas aneksit 4, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016” në transfertën specifike të bashkive: Berat, Cërrik, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Kavajë, Kolonjë, Korçë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Malësi e Madhe, Mat, Mirëditë, Përmet, Pukë, Sarandë, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Vau i Dejës, Vlorë, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të konvikteve të arsimit parauniversitar.

55. Sipas aneksit 4, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, në transfertën specifike të bashkive: Berat, Elbasan, Kuçovë, Kukës dhe Shkodër, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të shërbimit dhe shpenzimet operative për qendrat: “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan dhe



qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkitë: Kuçovë, Kukës dhe Shkodër.

56. Sipas aneksit 4, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, në transfertën specifike të bashkive janë të përfshira fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit arsimor në arsimin parashkollor, të shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashkollori dhe qendrat kulturore) dhe të personelit të shërbimeve mbështetëse për arsimin e mesëm, fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative të personelit të shërbimit për mbrojtjen nga zjarri, fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative të personelit të drejtorive rajonale të shërbimit pyjor, fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për ujitjen dhe kullimin, fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime për rrugët rurale.

57. Në detajimin e planit për investime me projekte përdoret kod i specifikuar me emërtimin e projektit përkatës.

58. Çdo njësi e qeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga Këshilli, depozitohet në Ministrinë e Financave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

59. Në vijim të përcaktimeve në udhëzimin e ministrit të Financave, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (pjesa e buxhetit vendor), procedura plotësuese për vitin 2016, janë si vijon:

a) Për funksionet e deleguara, “Shpenzimet për mbrojtjen sociale”, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2016, detajon fondet e mbrojtjes sociale në mënyrë periodike, për çdo njësi të qeverisjes vendore, si dhe në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Fondet e mbrojtjes sociale delegohen si transfertë e kushtëzuar për çdo njësi të qeverisjes vendore. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në detajimin e fondeve të mbrojtjes sociale, në mënyrë periodike, do të vlerësojë nevojat e njësive të qeverisjes vendore, duke mbajtur parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive,

transparente dhe mbi bazë kriteresh të përcaktuara;

b) Fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë që shpërndahen në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e tyre bëhen publike për të gjitha bashkitë;

c) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë financon bashkitë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore, që u shërbejnë individëve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi të bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit të bashkisë;

d) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë brenda buxhetit të miratuar të vitit 2016, mund të bashkëfinancojë ose të financojë qendra sociale në njësitë e qeverisjes vendore.

60. Fondet për Zhvillimin e Rajoneve do të shpërndahen në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në aneksin nr. 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

61. Në bazë të nenit 15, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta. Në personelin administrativ bëjnë pjesë punonjësit jo të zgjedhur. Paga e personelit administrativ e këshillave të qarqeve e muajit dhjetor 2015, që u jepet punonjësve në muajin janar 2016, do të jetë me numrin dhe strukturën e vitit 2015. Për punonjësit që mund të shkurtohen nga ristrukturimi i këshillave të qarqeve dhe që përfitojnë trajtim financiar sipas legjislacionit në fuqi, fondet përballohen nga buxheti i këshillit të qarkut (nga transferta e pakushtëzuar, kuotat e anëtarësisë dhe burime të tjera).

62. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 11.11.2015, “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrejtë të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, nëse ka efekte financiare, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit e këtyre ndërmarrjeve, bazuar në procedurat e parashikuara në Kodin e Punës, do të përballohen nga buxheti i këshillave të qarqeve.

63. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 11.11.2015, “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrejtë të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të



paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, bashkitë duhet të marrin masat e nevojshme për ushtrimin e këtij funksioni.

64. Sipas nenit 15, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, bashkitë duhet të përdorin jo më pak se 40 për qind të transfertës së pakushtëzuar, për investime publike.

65. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të përdorin fondet e akorduara si transfertë specifike, sipas tabelës 3 të ligjit, si kosto për personelin administrativ/shpenzime operative për çdo funksion, i cili transferohet nga ministria përkatëse.

66. Gjatë zbatimit të buxhetit, njësitë e qeverisjes vendore nuk mund të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të transfertave specifike ose t’i kalojnë nga njëri funksion tek tjetri. Këto fonde do të përdoren sipas destinacionit të përcaktuar në tabelën nr. 3 të ligjit të buxhetit të vitit 2016. Fondet e veta (transferata e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta), bashkitë mund t’i përdorin për përmirësimin apo rritjen e cilësisë së funksioneve, të cilat financohen me transferata specifike.

67. Sipas ligjit nr. 157, datë 27.11.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime nga njësitë e qeverisjes vendore. Renta minerare e mbledhur në muajin dhjetor 2015, të cilën drejtoritë rajonale të tatimeve/doganave e raportojnë pranë Ministrisë së Financave, në vitin 2016, të llogaritet si rentë për vitin 2016, kurse renta që do të mbledhet në muajin dhjetor 2016, të llogaritet si rentë për vitin 2017. Procedura më të detajuara në lidhje me rentën minerare janë në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 27, datë 16.12.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

68. Për llogaritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore do të merret parasysh ligji nr. 142, datë 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.1.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

69. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, brenda muajit janar 2016, nga buxheti i Ministrisë së

Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave ndan dhe detajon fondin, si dhe numrin e punonjësve për drejtoritë e bujqësisë, midis pushtetit qendror dhe bashkive, të cilat i shtohen transfertës specifike në tabelën 3 të ligjit.

70. Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar, në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e tyre. Ministrinë përgjegjëse për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përgatisin dhe nxjerrin standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit të zbatueshme për ambientet e arsimit parauniversitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen e bashkive në fushat me interes të qartë vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo bashkie.

71. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për të gjithë tatimpaguesit (tatimpaguesit familjarë dhe bizneset), në territorin përkatës.

72. Sipas tabelës 3 të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, shuma prej 2,450,000 mijë lekësh, do të përdoret për investime për funksionin e ujitjes dhe të kullimit. Fondi do t’u akordohet njësitë të qeverisjes vendore në vitin 2016 me vendim të Këshillit të Ministrave.

73. Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore përgatisin projektvendimin për Këshillin e Ministrave për ndarjen e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe të kullimit. Projektvendimi duhet të dërgohet për mendim të ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

74. Fondi rezervë përdoret sipas kritereve të përcaktuara në aneksin 2, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”. Njësitë e



qeverisjes vendore sipas kriterëve të këtij aneksi i drejtohen Ministrisë së Financave dhe ministri i Financave vlerëson kërkesën e tyre. Nëse fondi rezervë nuk përdoret brenda vitit 2016, ai trashëgohet si transfertë e pakushtëzuar për vitin 2017.

75. Fondet e papërdorura nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike gjatë vitit 2016, trashëgohen në buxhetin e vitit 2017.

III. Arkëtimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

76. Me implementimin e sistemit të ri informatik tatimor dhe me mbylljen e llogarive bankare në emër të drejtorive rajonale tatimore, kërkohet çdo ditë të sigurohet dërgimi elektronik në SIFQ, i arkëtimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga struktura përgjegjëse për tatimet, sipas klasifikimit ekonomik buxhetor.

77. Strukturat përgjegjëse për Thesarin në degë, nuk autorizojnë pagesën e pagës në muajin pasardhës, nëse nuk është kryer pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale, në muajin e mëparshëm nga njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore.

78. Për pagesën e muajit të fundit të vitit njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme të paraqesin së bashku me urdhërshpenzimin e pagave edhe konfirmimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues për mjaftueshmërinë e fondeve buxhetore për mbulimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

IV. Monitorimi

79. Raporti i monitorimit për vitin 2015, si edhe raportet periodike gjatë vitit 2016, që ministrinë dhe institucionet do të paraqesin në Ministrinë e Financave, duhet të plotësohen me informacionin si më poshtë:

- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;

- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë;

- Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;

- Të dhënat përkatëse për realizimin e financimit të huaj, si edhe analiza e tyre;

- Raportimi mbi shumat e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat jashtë limitit, i shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse lidhur me përdorimin e këtyre të ardhurave.

Të gjitha shpjegimet e mësipërme lidhur me performancën e produkteve duhet të paraqiten të lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit.

80. Raporti i monitorimit për vitin 2015 nga ana e njërive të qeverisjes qendrore do të paraqitet në Ministrinë e Financave, brenda datës 15 shkurt 2016. Në këto raporte, për programet që kanë ndryshuar sipas aktit normativ nr. 1, datë 29.7.2015, monitorimi me të gjithë treguesit vjetorë do të paraqitet nga ministrinë dhe institucionet aktuale.

V. Përcaktime të fundit

81. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë formatet e zbatimit të buxhetit, bashkëlidhur si më poshtë:

a) Tabela 1 “Fondi i veçantë limit për vitin 2016”;

b) Shtojca 1 “Formati i detajimit të fondeve buxhetore”;

c) Shtojca 2 “Formati i transferimit të fondeve buxhetore”;

d) Shtojca 3 “Zbatimi i fondit limit të pagave”;

e) Shtojca 4 “Borderoja e pagave të njërive të qeverisjes së përgjithshme”;

f) Shtojca 6 “Raportimi i financimeve të huaja”;

g) Shtojca 7 “Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve buxhetorë”;

h) Shtojca 8 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”;

i) Shtojca 9 “Raporti i realizimit të rezultateve të programit”;

j) Shtojca 10 “Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas rezultateve”;

k) Shtojca 11 “Raporti i projekteve me financim të brendshëm”;

l) Shtojca 12 “Raportimi i fondit të pagave dhe numrit të punonjësve të njësisë së qeverisjes vendore”;

m) Shtojca 12/1 “Transferta specifike dhe numri i punonjësve të njërive të qeverisjes vendore, për funksionet e transferuara nga pushteti qendror”;

n) Shtojca 13 “Shkresa e njërive vendore për hapje llogari bankare huamarrjeje”;



o) Shtojca 14 “Formati i raportimit të aktiveve në pronësi”, sipas paragrafit 258, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012.

82. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 dhjetor 2016.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Tabela 1. "Fondi i veçantë limit për vitin 2016"		ne leke
Kod min	Emertimi i Ministrisë / Institucionit Buxhetor	Limit Fondi Veçantë 2016
1	Presidenca	377,110
2	Kuvendi	1,314,924
3	Kryeministria	2,629,849
4	Ministria Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë Sipërmarrjes	2,907,720
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	9,914,034
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2,034,411
10	Ministria e Financave	15,471,450
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	154,744,272
12	Ministria e Kulturës	5,031,447
13	Ministria e Shendetësisë	17,277,610
14	Ministria e Drejtësisë	23,896,890
15	Ministria e Punëve të Jashtme	699,639
16	Ministria e Brendshme	70,345,974
17	Ministria e Mbrojtjes	45,888,380
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	4,530,287
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	689,715
22	Akademia e Shkencës	143,897
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	873,308
25	Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë	14,945,480
26	Ministria e Mjedisit	4,758,538
28	Prokuroria e Përgjithshme	4,282,188
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	6,718,519
30	Gjykata Kushtetuese	267,947
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	198,479
50	Instituti Statistikës	1,071,787
55	Shkolla e Magjistraturës	119,087
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	44,658
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	248,099
66	Avokati i Popullit	272,909
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	153,821
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	272,909
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	297,719
77	Autoriteti i Konkurrencës	183,593
78	Ministria e Integritetit	545,818
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	29,772
87	Institucione të tjera Qeveritare	1,592,795
	<i>Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar</i>	<i>148,859</i>
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	<i>143,897</i>
	<i>Komiteti Shtetëror i Minoriteteve</i>	<i>39,696</i>
	<i>Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit</i>	<i>74,430</i>
	<i>Komisioni i Prokurimit Publik</i>	<i>109,164</i>
	<i>Inspektoriati Qendror</i>	<i>74,430</i>
	<i>Sekretariati i Ujit</i>	<i>114,126</i>
	<i>Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale</i>	<i>69,468</i>
	<i>Agjencia e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog</i>	<i>49,620</i>
	<i>Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal</i>	<i>248,099</i>
	<i>Agjencitë e Zhvillimit Rajonal (4)</i>	<i>396,958</i>
	<i>Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal</i>	<i>124,049</i>
88	Mbështetje për shoqërinë civile	79,392
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Dhënave Personale	173,669
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	114,126
92	Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit	74,430
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2,123,727
94	Ministria e Zhvillimit Urban	2,560,381
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit	99,240
	Totali	400,000,000

Shtojca Nr.1: Formati i Detajimit te fondeve buxhetore 2016 per Njesine e Qeverisjes _____

Shembull: AUTORITETI KONKURRENCES

(Ne leke)

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Deges Thesarit	Debiti	Kodi I projektit	Emertimi Projektit
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrences	01	04110	6000000	3535	33,400,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrences	01	04110	6010000	3535	5,600,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrences	01	04110	6020000	3535	13,000,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrences	01	04110	2310000	3535	2,500,000	M770006	Blerje autoveture
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrences	01	04110	2310000	3535	1,000,000	M770003	Blerje pajisje kompjuterike
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrences	01	04110	2310000	3535	500,000	M770002	Blerje pajisje zyre
TOTALI								56,000,000		



Shtojca Nr.2

Formati I transferimit te fondeve buxhetore 2015

leke

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi Institucioni	Emer institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Degese Thesarit	KOD PROJEKTI	Emertimi I projektit	Debiti
			Pakesohet							950,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	6000000	0202			400,000
001	06	1006075	Drejtoria Rajonale Rrugore Lezhe	01	04520	6000000	2020			150,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	2300000	0202	M061903	Studim projektim ...	400,000
			Shtohet							
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	6010000	0202			300,000
001	06	1006060	Drejtoria Rajonale Rrugore Durres	01	04520	6010000	0707			250,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	2310000	0202	M061860	Sistemim asfaltim rruga t	400,000





SHTOJCA NR. 3 “ZBATIMI I FONDIT LIMIT TË PAGAVE”

Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahet në konsideratë që:

I. Referuar ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 “Për Kompetencat për Përcaktimin e Pagave dhe të Shpërblimeve”, neni 2, në administratën publike, të drejtën për caktimin e pagës e kanë vetëm Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave.

II. Referuar ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar, Neni 3, paga më e lartë në institucionet e administratës publike, buxhetore dhe jo buxhetore, në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës, e cila përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit. Paga minimale mujore në shkallë vendi dhe kufiri minimal mujor për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

III. Paga e funksionarëve të lartë shtetëror të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 i sipërcituar, përcaktohet në raport me pagën e Presidentit sipas lidhjes përkatëse të këtij ligji.

IV. Pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 i sipërcituar, si dhe pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar të gjithë njësisive të qeverisjes së përgjithshme, përcaktohen me Vendimin me nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim. Në këtë vendim, vlera e pagës së diplomës është e grupuar në 3 nivele dhe çdo pozicion pune ka një emërtesë të përcaktuar që i përgjigjet detyrimisht një niveli të caktuar të diplomës (pagës së grupit). Kjo nënkupton që në një funksion, i cili ka në emërtesën e tij, pagën e grupit 1, nuk mund të emërohet një nëpunës, i cili ka përfituar një diplomë të grupuar në nivelin 2. Vendimi i sipërcituar, i miratuar me ndryshime në vitin 2015, përmban rikthimin e të drejtës për të përfituar shtesën e pagës për kushte pune për punonjësit në sektorët e IT, më datë 1 janar 2016. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave. Kërkesa për miratim në Ministrinë e Financave do të paraqitet pas miratimit të saj nga DAP, duke bashkëlidhur në dokumentet e kërkuara sipas vendimit të sipërcituar edhe një kopje të shkresës miratuese të DAP. Në rast se për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit përfitues të kësaj shtese, parashikohen shtesa të tjera për kushte pune, këta nëpunës do të zgjedhin ndërmjet dy shtesave por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të dyja shtesat.

V. Pagat e të gjithë punonjësve të administratës publike që klasifikohen si punonjës mbështetës, pavarësisht arsimimit individual të tyre, përcaktohen në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim.

VI. Pagat e punonjësve të sistemit arsimor, të sistemit shëndetësor, të sistemit me grada si dhe të punonjësve të Aviacionit Civil dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, përcaktohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.



SHTOJCA NR.4 "BORDEROJA E PAGAVE TE NJESIVE TE QEVERISJES SE PERGJITHSHME"

Institucionit:Kodi Institucionit

1	2	3	4	5	6	7	8			11	12	13	14	15
Emri Mbiemri	Emertesa sipas struktures se miratuar	D.pune (+L.zako nsh.)	Kategoria (klasa)	Paga grupit	Paga per funksion	Raporte mjekesore te paguara nga punedhene si (6001002)	Shtese page per vjetersi ne pune (6001003)			Shtesa page per veshtiresi dhe rrezique (600.1004)	Shtesa page per funksion (6001005)	Shtese page per turme te dyta dhe te treta (6001006)	Shtesa per page per largesi nga qendra e banimit (6001007)	Shtese page per Kualifikim (6001008)
							Vite	%	Lek					
25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39
Kufiri pages	Ndalesat					Shuma Neto	Dite kalenda rike pa punuar gjate muajit (e drejta per peritimit e nga	Dite kalenda rike te punuara te subj ekti gjate	Paga Bruto ne Leke		Kontribute per Sigurimet Shoqerore ne Leke			
	11.2% (Sig. shoq.)	Tatim Page	Sig.suple mentar	Te Tjera (telefon etj.)	Shuma Ndalesa				Gjithsej	Mbi te cilen logariten kontribut et	Nga keto:		Kontribut e shtese (sigurime t suplementare)	
										Gjithsej	Punedhene si	Punemarre si		

Formati i Borderose eshte ndare ne dy pjese, nga te cilat:

(i) Per kolonat nga 1-24 jane futur te gjitha elementet perberes se pages me te gjitha shtesat perkatese te saj.

Per ato insitucione te cilat sipas VKM perkatese te pagave nuk i zbatojne te gjitha shtesat e paraqitura ne kete format, mund t'i heqin disa prej ketyre kolonave gjate perdorimit

(ii) Ne kolonat nga 25 -48 jane paraqitur te gjitha ndalesat perkatese

Autorizimi i fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore kryhet mbi bazen e listepageses mujore (borderose) te plotesuar detyrimisht sipas formatit te paraqitur ne shtojcen nr.1, bashkohohet dhe pjese perberese e ketij udhezimit.

Ky format i cili permban te gjitha elementet perberes te domosdoshem per kryerjen e pages mujore se punonjesit te plotesohet i vecante per punonjesit organik dhe per punonjesit me kontrate te perkohshme pune.

Per efekt te unifikimit ky format te plotesohet duke mbajtur ne konsiderate qe muaji ka 22 dite pune.

15	17	18	19	20	21	22	23	24
Shtesa per page per gradat ushtarake (6001009)	Shtesa per ushtaraket e liruar ne reforme (600101)	Shtesa page per bashkeshortet e papunat e ushtarakete transferuar (6001011)	Shtesa page dhe page e menjeheresh me per funksionaret e larte (6001012)	Shtese page per pune jashte orarit (6001013)	Shtesa per page per punonjesit qe rregullohen me akte te vecanta (6001014)	Shperblime per rezultate ne pune (60031)	Te tjera shperblime per personelin (60039)	Paga bruto mujore
40	41	42	43	44	45	46	47	48
Kontribute per Sigurimet Shendetesore Gjithsej	Paga Bruto mbi te cilen llogariten Tatimet mbi te ardhurat nga punesimi	Tatimet mbi te ardhurat nga punesimi	Paga mujore	% Sig.Suplementar	Sig.Suplementar	Banka	Nr. Llogarise	Vlera leke



Shtojca Nr. 7 "Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetore"

Grupi							Kodi
Programi							Titulli
Artikulli Kodi	Emri	Totali Shpenzimeve					
		(1) MTBP Plan 2014	(2) Buxheti 2014	(3) Buxheti Perfundimtar 2014	(4) Fakti 2014	(5)=(2)-(4) Diferenca 2014	
600	Paga						
601	Sigurime Shoqërore						
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera						
603	Subvencione						
604	Transferta Korente të Brendshme						
605	Transferta Korente të Huaja						
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ						
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
230	Kapitale të Patrupëzuara						
231	Kapitale të Trupëzuara						
232	Transferta Kapitale						
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali	Korrente dhe Kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Jashte Buxhetore		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Sekretari i Përgjithshëm	Emri			
	Firma			Firma			
	Data			Data			





Shtojca Nr. 8 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

Emri i Grupit		Kodi i Grupit				
		Shpenzimet e Ministrisë				
Programet		PBA	Budget	Buxheti	Fakti	Diferenca
Titulli	Emri	Plan 2014	2014	perfundimtar 2014	2014	2014
0001	Programi 1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		0.0	0.0		0.0	- 0.0

Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma	
	Data	

Shtojca Nr.9 "Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit"

Grupi					Kodi				
Programi					Titulli				
Kodi I			Sasia e Planifikuar fillestare	Sasia e Planifikuar perfundimtare	Sasia e Realizuar	Realizimi			Komente
Rezultatit	Emri i Rezultatit	Njësia Matëse				Plotesisht	Pjesërisht	Aspak	
A	Rezultati A								
B	Rezultati B								
C	Rezultati C								
D	Rezultati D								
E	Rezultati E								

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	



Shtojca Nr.10 "Raporti I Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Rezultateve"

Grupi		Kodi							
Programi		Titulli							
		Shpenzimet e Rezultatit				Kosto per njesi			
Kodi i Rezultatit	Emri i Rezultatit	PBA Plan 2014	PL Buxheti fillestar 2014	PI buxheti perfundimtar 2014	Fakti 2014	Kosto per njesi Plan 2014	Kosto per njes Fakt 2014	Shpjegime	
A	Rezultati A	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	
B	Rezultati B	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	
C	Rezultati C	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	
D	Rezultati D	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	
E	Rezultati E	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	



Shtojca Nr.11 "Projektet me financim te brendshem"

000/ Leke

Kodi projektit	Emertimi I projektit	Vlera e plote e projektit	Buxheti _____	Plani I buxhetit viti _____	Shpenzimi realizuar
			Kontraktuar		

Projektet me financim te huaj

000/ Leke

Kodi projektit	Emertimi I projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plote e projektit	Plani I buxhetit viti _____	Shpenzimi realizuar



Shtojca Nr. 12

Raportimi i Fondit te pagave dhe Numrit te punonjesve te njesise se qeverisjes vendore

Emri i njesise	Viti 2009 (fakti)		Viti 2010	
	Numri i punonjesve	Fondi i pagave (ne leke)	Numri i punonjesve	Fondi i pagave (ne leke)
Administrata e njesise	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjes me kontrate (Administrata)	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet e varesise	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjes me kontrate (Institucionet e varesise)	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	0.0	0.0	0.0	0.0



Shtojca 12/1 "Transferta specifike dhe numri i punonjësve të njësitëve qeverisjes vendore, për funksionet e transferuara nga pushteti qendror"

në mijë lekë

Nr.	Emri Institucioni	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar		Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH)		Administrimi i pyjeve		Ujitja dhe kullimi	
		Totali	Numri i punonjësve	Totali	Numri i punonjësve	Totali	Numri i punonjësve	Totali	Numri i punonjësve	Totali	Numri i punonjësve
1	Bashkia Belsh	20,945	30	929	2	0	0	613	1	2,198	1
2	Bashkia Berat	117,645	194	6,499	14	26,565	31	2,453	4	6,459	4
3	Bashkia Bulqize	48,370	75	0	0	8,269	9	2,453	4	5,227	2
4	Bashkia Cerrik	37,835	57	3,714	8	0	0	613	1	5,843	3
5	Bashkia Delvine	20,179	32	1,392	3	6,804	9	613	1	2,198	1
6	Bashkia Devoll	47,279	69	1,857	4	3,435	4	1,840	3	3,430	3
7	Bashkia Dibër	115,666	184	5,107	11	19,043	21	2,453	4	5,843	3
8	Bashkia Divjake	34,585	50	929	2	0	0	613	1	13,184	11
9	Bashkia Dropull	2,119	3	929	2	0	0	613	1	5,227	2
10	Bashkia Durrës	153,525	252	14,856	32	39,466	43	1,226	2	26,497	18
11	Bashkia Elbasan	214,868	344	26,463	57	27,487	31	3,066	5	6,459	4
12	Bashkia Fier	168,475	267	8,357	18	29,727	30	2,453	4	19,345	21
13	Bashkia Finiq	7,527	11	0	0	0	0	613	1	7,075	5
14	Bashkia F- Arrez	23,408	40	3,714	8	0	0	3,679	6	2,198	1
15	Bashkia Gjirokastrë	81,120	132	4,642	10	25,327	30	2,453	4	8,255	3
16	Bashkia Gramsh	64,855	98	2,786	6	8,110	9	2,453	4	2,198	1
17	Bashkia Has	25,385	38	2,321	5	8,962	9	3,066	5	2,198	1
18	Bashkia Himarë	11,058	16	464	1	6,804	9	1,226	2	2,198	1
19	Bashkia Kamëz	92,945	146	7,892	17	0	0	0	0	2,814	2
20	Bashkia Kavajë	65,926	105	3,714	8	12,471	17	613	1	10,720	7
21	Bashkia Këlcyre	7,749	12	2,321	5	0	0	613	1	2,198	1
22	Bashkia Klos	22,762	36	1,392	3	0	0	2,453	4	2,198	1
23	Bashkia Kolonjë	29,824	46	3,250	7	7,495	9	3,066	5	2,814	2
24	Bashkia Konispol	6,114	9	0	0	0	0	613	1	2,814	2
25	Bashkia Korçë	163,270	261	14,856	32	25,356	31	3,066	5	19,961	22
26	Bashkia Krujë	49,460	81	2,786	6	12,056	13	3,066	5	7,691	6
27	Bashkia Kuçovë	60,255	98	4,642	10	11,249	13	613	1	5,227	2
28	Bashkia Kukës	83,624	140	3,714	8	41,137	42	3,066	5	5,227	2
29	Bashkia Kurbin	71,797	114	9,285	20	7,851	9	613	1	11,336	8
30	Bashkia Lezhë	95,447	154	8,357	18	25,735	30	3,066	5	13,184	11
31	Bashkia Libohovë	3,995	6	929	2	0	0	613	1	2,198	1
32	Bashkia Librazhd	66,025	100	2,321	5	8,110	9	3,066	5	5,227	2
33	Bashkia Lushnjë	134,252	211	8,821	19	11,622	13	1,226	2	21,193	24
34	Bashkia Malësi e Madhe	40,216	59	4,178	9	8,027	9	3,679	6	4,046	4
35	Bashkia Maliq	50,103	73	6,036	13	0	0	1,226	2	15,084	18
36	Bashkia Mallakastër	55,352	89	4,178	9	8,764	9	613	1	5,227	2





37	Bashkia Mat	61,668	100	4,642	10	8,269	9	2,453	4	2,198	1
38	Bashkia Memaliaj	30,066	46	6,036	13	0	0	613	1	2,198	1
39	Bashkia Mirditë	51,579	84	6,036	13	7,851	9	3,066	5	5,227	2
40	Bashkia Patos	38,441	63	2,786	6	8,764	9	0	0	2,814	2
41	Bashkia Peqin	31,721	48	929	2	3,709	4	613	1	2,198	1
42	Bashkia Permet	21,592	34	2,321	5	7,729	9	2,453	4	2,198	1
43	Bashkia Pogradec	106,078	155	7,428	16	10,742	13	2,453	4	2,814	2
44	Bashkia Poliçan	26,051	41	3,250	7	3,591	4	1,226	2	2,198	1
45	Bashkia Prenjas	29,137	44	2,321	5	0	0	2,453	4	2,198	1
46	Bashkia Pukë	30,674	52	5,571	12	11,512	13	3,679	6	2,198	1
47	Bashkia Pustec	4,943	7	0	0	0	0	613	1	2,198	1
48	Bashkia Roskovec	18,100	27	1,857	4	0	0	0	0	5,843	3
49	Bashkia Rrogozhine	25,587	40	1,857	4	0	0	613	1	2,198	1
50	Bashkia Sarandë	42,437	69	2,321	5	12,676	17	1,840	3	5,227	2
51	Bashkia Selenice	18,544	29	4,178	9	0	0	613	1	5,227	2
52	Bashkia Shijak	38,522	59	2,321	5	0	0	613	1	5,227	2
53	Bashkia Shkoder	143,133	239	19,963	43	30,678	35	3,679	6	11,388	12
54	Bashkia Skrapar	38,683	63	3,714	8	7,846	9	1,226	2	2,198	1
55	Bashkia Tepelene	33,557	53	2,786	6	7,729	9	613	1	2,198	1
56	Bashkia Tiranë	582,975	1003	70,103	151	90,019	116	3,679	6	5,843	3
57	Bashkia Tropojë	42,458	68	2,786	6	8,962	9	3,066	5	2,198	1
58	Bashkia Ura Vajgurore	27,543	39	464	1	0	0	613	1	3,430	3
59	Bashkia V.Dejes	21,893	31	1,857	4	0	0	1,840	3	4,046	4
60	Bashkia Vlore	160,389	272	20,427	44	25,922	35	3,066	5	21,649	15
61	Bashkia Vore	31,519	46	1,857	4	0	0	613	1	2,198	1
	Shuma	3,951,250	6,344	351,442	757	635,874	739	105,468	172	372,500	267



Shtojca Nr. 13 "Shkresa e Njesive Vendore per Hapje Llogarie Huamarrjeje"

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHEME E THESARIT
DREJTORIA OPERACIONALE

Nr. 2016/13 Prot.

Tirane, me 02.02.2016

Per: **BANKA KOMBETARE TREGTARE**Per njoftim: Dega e Thesarit Elbasan
Bashkia Elbasan


Suhjekti: Kerkese per hapje llogarie

Ne zbatim te Ligjit Nr.9860, dt.04.02.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" si dhe Udhезimit te Ministrise se Financave Nr.35, dt. 05.04.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", luteni te hapni prane Bankes Kombetare Tregtare Dega Elbasan, llogarine tranzite per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore: "Dega e Thesarit Elbasan-Huamarrje Njesia Vendore" ne LEK.

Kja llogari du te funksionoje ne perputhje me Akt-Marrovshjen midis Ministrise se Financave dhe Bankes tuaj.

Pas hapjes se kësaj llogarie, lutemi njoftoni numrin e saj IBAN prane Deges se Thesarit Elbasan dhe Ministrise se Financave - Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit - Drejtoria Operacionale.

Ridvan BODE



Shtojca 14/1 "Formati i raportimit te aktiveve ne pronesi"

OBJEKTET SHETERORE TE DHENA ME QERA NGA NJESITE E QEVERISJES SE PERGJITHSHME
 MINISTRIA/INSTITUCIONI _____

NR	EMERTIMI I OBJETEVE TE DHENA ME QERA	Sip.objek m2	Afati i qerase	Veprimta. qe kryhet	Qeraja mujore	Arketimet					Adresa e plote e subjektit perfitues te objektit me qera
						Jenar	Shkurt	Mars	Prill	xxx	
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											



Shtojca 14/3 "Formati i raportimit te aktiveve ne pronesi"

PASQYRA PER RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE TE DHENA ME KONÇESION
 MINISTRIA E _____

Nr	SHOQERIA KONÇESIONARE	OBJEKTI KONÇESIONIT	NIPTI	AFATI KONÇES. NE VITE	KUSHTI BAZE I PAGESES	FILLIMI I PAGESES	ARKETUAR			ADRESA E PLOTE E SELISE SE SHOQERISE KONÇESIONARE NR. KONTAKTI TEL, CEL.	
							DERI NE VITIN xxx	VITI RAPORTUS			VITI PL PARASH
								LLOG.	DEROH		
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											
16											
17											
18											



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë